




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK.nr.318/2022**  
**Datë: 28 korrik 2022**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Naime Krasniqi Jashanica, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, sipas Raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/04/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR/46/21, të datës 4 maj 2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancat dëgjimore të mbajtur me datë 28 korrik 2022, nxjerr:

### V E N D I M

- I. Naime Krasniqi Jashanica, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, është përgjegjëse për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafin 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë.
- II. Për këtë shkelje disiplinore gjyqtares Naime Krasniqi Jashanica i shqiptohet sanksioni disiplinor transferim i përhershëm nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë në Departamentin e Përgjithshëm të të njëjtës Gjykatë.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 31 janar 2022 ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetent me pretendim se znj. Naime Krasniqi Jashanica, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinor të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe pikën 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar. Përmes kësaj kërkeje është kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor, me ç'rast ka propozuar që nëse vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore nga gjyqtarja Krasniqi Jashanica, t'i shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara në dispozitën e nenit 7, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent kërkesës së lartcekur i ka bashkangjitur provat të cilat i ka marrë për bazë për inicim të procedurës disiplinore kundër gjyqtares Krasniqi Jashanica.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.50/2022, të datës 10 shkurt 2022, ka themeluar panelin hetimor për lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/04/2022/GJTHPR-AD/GJTHPR/46/21, i cili panel me datë 4 maj 2022, i ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar dhe marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar të arritur në mes të panelit dhe subjektit të hetimit disiplinor gjyqtarës Krasniqi Jashanica.

Këshilli për ta shqyrtuar marrëveshjen ka caktuar dhe mbajtur seancë me datë 31 maj 2022, pa prezencën e palëve.

Pasi ka shqyrtuar marrëveshjen, Këshilli në mënyrë unanime ka vendosur që marrëveshja vullnetare së bashku me sanksionin “vërejtje jopublike me shkrim”, të refuzohet me arsyetim që sanksioni i arritur në mes të panelit dhe subjektit të hetimit gjyqtarës Naime Krasniqi Jashanica është jo proporcional me shkeljen dhe pasojat e shkeljes disiplinore, shkelje kjo e vërtetuar edhe nga ana e panelit hetimor.

Për ta shqyrtuar raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura, Këshilli seancën dëgjimore të radhës e ka caktuar dhe mbajtur me datë 7 korrik 2022, në të cilën kanë prezantuar kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Venhar Salihu dhe subjekti i hetimit gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica.

Kryesuesi i panelit hetimor në seancën dëgjimore para Këshilli ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë marrëveshjes vullnetare për rastin konkret, pasi që subjekti i hetimit gjyqtarja Krasniqi Jashanica ka pranuar gjendjen faktike për shkeljen e pretenduar nga Autoriteti Kompetent, përkatësisht mos procedimin me kohë të rastit penal në procedurë paraprake me numër PPRKR.nr.741/21 edhe për kundër qe ka qenë e njoftuar nga prokurorja e rastit përmes telefonit dhe postës elektronike.

Për panelin hetimor ka qenë jo kontestuese fakti se subjekti i hetimit gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica në çështjen penale PPRKR.nr.741/21, në të cilën kishte vepruar si gjyqtare e procedurës paraprake, nuk kishte vepruar sipas autorizimeve të saja brenda afatit ligjor duke mos e trajtuar kërkesën për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, si pasojë e së cilës i pandehuri ishte liruar në mënyrë të rregullt.

Sipas të gjeturave të panelit hetimor të bazuara në deklaratën e subjektit të hetimit dhe provave në shkresat e lëndës, gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica me mos trajtimin e rastit penal përkatës, ka shkelur nenin 5, nën pika 1.3 përkatësisht ka kryer shkeljen e detyrës zyrtare si gjyqtar.

Marrë parasysh që Këshilli e ka refuzuar marrëveshjen e arritur, kryesuesi i panelit në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga KGJK që ta shqyrtoj raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe të vendos lidhur me shkeljen e vërtetuar dhe të pranuar edhe nga subjekti i hetimit.

Subjekti hetimor gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica, në seancën dëgjimore në Këshillin Gjyqësor të mbajtur më datë 7 korrik 2022, është deklaruar lidhur me pretendimet e Autoritetit Kompetent se nuk kishte vepruar konform ligjit lidhur me rastin e caktimit të paraburgimit sipas prokurores kujdestare. Gjyqtarja Krasniqi Jashanica në seancë ka deklaruar se të njëjtën ditë si gjyqtare e procedurës paraprake ka pranuar një kërkesë tjetër për caktim të paraburgimit nga ana e prokurores M.L. Për këtë rast ka përfunduar e gjithë procedura, ishte nxjerrë aktvendimi dhe të njëjtin e ka



ekspedituar për të gjithë palët. Në ora 13:30, ditë e shtunë, me datë 04.12.2021 si gjyqtare kujdestare ka dalë nga zyra, ka shkuar në fshat dhe në zyrën e saj në gjykatë ishte e pranishme vetëm zyrtarja juridike. Gjatë të njëjtës ditë, rreth orës 3 pasdite, gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica ishte kontaktuar përmes telefonit nga prokurorja M.L., e cila e kishte njoftuar se është edhe një kërkesë për arrest shtëpiak, lidhur me një vepër penale që nuk bie në kompetencën e krimeve të rënda, por ka qenë e natyrës së lehtë të lëndimeve.

Gjyqtarja Krasniqi Jashanica në telefon i kishte thënë prokurores së rastit se nuk ka qasje në internet sepse ndodhet në fshat dhe i duhet të koordinoj datën për caktim të seancës. Sipas deklaratës së subjektit të hetimit, prokurorja i kishte thënë se keni afat deri të hënën. Gjyqtarja Krasniqi Jashanica, të hënën vijuese, kishte dalë në punë në ora 9 dhe kishte kërkuar nga sekretarja juridike që të thërrasë palët lidhur me kërkesën për caktimin e arrestit shtëpiak. Po ashtu, subjekti i hetimit, gjyqtarja Krasniqi Jashanica ka deklaruar se kërkesën për caktimin e arrestit shtëpiak nga prokurorja e rastit e ka pranuar me datë 06.12.2021 dhe jo me datë 04.12.2021.

Sipas gjyqtares Krasniqi Jashanica kërkesën për caktimin e paraburgimit për procedimin e lëndës përkatëse PPRKR.nr.741/21, nuk e kishte pranuar në formë të shkruar dhe jo me datë 04.12.2021, por vetëm ishte telefonuar nga prokurorja. Më tutje subjekti i hetimit gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica ka vazhduar duke thënë se mund ta ketë pranuar me email apo përmes Smilit mirëpo ajo nuk ka pasur qasje në internet dhe se në gjykatë gjatë ditëve të vikendit zyra e referentëve është e mbyllur dhe nuk funksionon sistemi i Smilit.

Gjatë deklaratës së saj, gjyqtarja ka njoftuar Këshillin se fillimisht që ajo ka lidhur marrëveshjen për pranimin e fajësisë me panelin hetimor dhe se këtë veprim e ka marrë pasi që se nuk ka dashur të paraqitet para Këshillit.

Në fund, gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica ka deklaruar se pranon cilindo sanksionon disiplinor që do t'a shqipton Këshilli për një gjyqtare të procedurës paraprake kur nuk asistohet nga asnjë zyrtare e gjykatës.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura të panelit hetimor; kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore të Autoritetit Kompetent të datës 31 janar 2022; E-mailin e datës 23 dhjetor 2021, komunikim në mes të Kryesuesit Albert Zogaj dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme Enver Peci; E-mailin përkatësisht komunikimi në mes të Prokurores dhe Kryetares se Gjykatës Themelore në Prishtine Albina Shabani Rama, të datës 06 dhjetor 2021; E-mailin e datës 06 dhjetor 2021 në mes Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtine Albina Shabani Rama dhe Zyrtarit Aktvendimi PN.nr.1473/21, i datës 15.11.2021, aktvendim ky lëshuar nga Gjykata e Apelit; E-maili i datës 30 dhjetor 2021 në mes zyrtarit ; E-maili i datës 06 dhjetor 2021, në mes të zyrtarit dhe Naime Krasniqi Jashanica; Deklarata nën betim të dhënë nga subjekti i hetimit gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica; Shënimi zyrtar i datës 06.12.2021, i gjyqtares Naime Krasniqi Jashanica; Kërkesa për caktimin e masës së arrestit shtëpiak të datës 04.12.2021, me numër PPI/nr.859/21 ku në këtë kërkesë shihet se e njëjta është pranuar në gjykatë me datë 06.11.2021, në ora 09:30; Aktvendimi i datës 06.12.2021 Nr. PKRKR/741/21 i nxjerr nga Gjykata Themelore në Prishtinë, përkatësisht gjyqtarja e procedurës paraprake Naime Krasniqi Jashanica; Aktvendimi për fillimin e fazës së hetimeve i datës 04.12.2021, aktvendim ky i nxjerrë nga Prokuroria M.L.; Aktvendimi i datës 06.12.2021 i nxjerr nga gjyqtarja Naime Krasniqi; Kërkesa për caktimin e paraburgimit e paraqitur nga



prokuroria M.L; Aktvendimi për fillimin e fazës së hetimeve PP/1 nr.885/21 e paraqitur nga prokuroria M.L; Procesverbali PPR.nr.738/21 i datës 04.12.21; Urdhri për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.12.2021, i nxjerrë nga gjyqtarja Nairne Krasniqi; E-maili i dërguar nga M.L për Nairne Krasniqi i datës 04 dhjetor 2021, në ora 13:37 minuta, ku në këtë email shihet se prokurorja M.L ka kërkuar që të konfirmohen dokumentet e dërguara në shtojce të këtij emaili edhe atë kërkesa për arrest shtëpiak dhe aktvendimi për fillim të hetimeve; Aktvendimi PPRKR nr.738/21 i nxjerrë nga Gjykata Themelore ne Prishtinë, përkatësisht gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica; E-maili i datës 03 dhjetor 2021, i orës 13:37, dërguar nga gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica për prokuroren M.L. ku gjyqtarja ka konfirmuar kërkesën për caktimin e paraburgimit dhe aktvendimin për hapjen e hetimeve; Komunikimi me e-maili dërguar nga M.L i datës 03 dhjetor 2021, i orës 03:27 ku prokurorja në fjalë i ka dërguar gjyqtarës Naime Krasniqi kërkesën për paraburgim dhe aktvendimin për fillimin e hetimeve; Komunikimi i dërguar A.N. te D.G. , i datës 06 dhjetor 2021, ora 12:42, ku si subjekt është kërkesa për masë; komunikimi në mes A.N., i datës 06 dhjetor 2021 dërguar D.G. dhe si shtojcë të bashkangjitur Aktvendimin lidhur me hetimet; Flet konfirmimi me numër të lëndës 2021-272549, i datës 06.12.2021 nga kjo vërtetohet se Prokuroria Themelore ne Prishtinë, në ora 08:50, të datës 06.12.2021 ka dorëzuar një kërkesë për masë; Konfirmimi i pranimit nga Smili me numër 2021-272549, me numër të dokumentit 02471435, ku vërtetohet se Prokuroria Themelore ne Prishtine me datën 06.12.2021, në ora 08:10 minuta ka dorëzuar aktvendimin për fillimin e hetimeve; Procesverbali në lëndën 741/21; Procesverbali mbi seancën dëgjimore në rastin PKRKR.nr.741/21 i datës 06.12.2021, i përpiluar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë nga gjyqtarja subjekt i hetimit Naime Krasniqi Jashanica.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli vendosi që seancën ta vazhdojë me datë 15 korrik 2022. KGJK në seancën e datës 15 korrik 2022, pasi ka analizuar çështjen dhe të gjitha provat e bashkangjitura, ka vendosur që t'i drejtohet Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, me kërkesë që të qartësohet baza ligjore dhe praktika që ndiqet nga Gjykata Themelore në Prishtinë në rastin kur ka kërkesë nga prokurori për caktimin e paraburgimit dhe të shpjegojë se në çfarë forme pranohen kërkesat në procedurën paraprake gjatë vikendit, cila është përgjegjësia e gjyqtarit dhe referentit përkatës në pranimin e kërkesave dhe rrjedhimisht në çfarë forme zhvillohet komunikimi në mes të gjyqtarit dhe prokurorit të çështjes.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 18 korrik 2022, i ka kthyer përgjigje Kryesuesit dhe e ka sqaruar procedurën e veprimit të gjykatës përkatëse gjatë ditëve të vikendit me lëndët e paraburgimit nga ana e gjyqtarëve kujdestarë. Këshilli pas pranimit të kësaj informate ka caktuar dhe ka mbajtur me datë 28 korrik 2022, seancën e radhës për këshillim dhe votim.

Sipas Kryetares se Gjykatës Themelore në Prishtinë, në praktikë gjatë ditëve të vikendit në gjykatë asnjëherë nuk kujdestarojnë referentet për pranimin e lëndëve. Referentët e pranimit të premten i njoftojnë gjyqtarët kujdestarë me numrin rendor të regjistrimit fizik, në mënyrë që të evidentohen lëndët e reja të pranuar gjatë vikendit nga gjyqtarët. Koordinimi i pranimit të lëndëve bëhet në mes gjyqtarit kujdestar me prokurorin kujdestar. Fillimisht prokurori kujdestar e njofton gjyqtarin kujdestar përmes telefonit se do të sjellin një kërkesë për caktim të masës së siguresë. Prokurori është i obliguar që kërkesën ta dorëzojë brenda 24 orëve prej momentit që e ka ndaluar personin e dyshimtë. Për të arritur afatin 24 orësh pasi që shpesh kjo kohë i bie edhe në orët e vona të natës, kërkesën për caktim të paraburgimit ose masës tjetër siguresë prokurori e dërgon të gjyqtarit kujdestar përmes emailit dhe kjo konsiderohet si dorëzim i rregullte në gjykatë si dhe konsiderohet se prokurori e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor. Gjyqtari kujdestar sa më shpejt që është e



mundur jo më vonë se 24 orë nga pranimi i kërkesës për caktim të paraburgimit (përmes emailit), duhet të dal në gjykatë dhe ta pranoj lëndën fizikisht si dhe përmes SMIL ( nëse lenden e ka pas në procedure paraprake edhe më parë me masa të fshehta, nëse jo lënda pranohet vetëm fizikisht dhe në ditën e parë të punës regjistrimin i lëndës bëhet edhe përmes SMIL nga referentet e pranimit). Fizikisht lëndën në gjykatë e dorëzon vet prokurori kujdestar ose zyrtari i tij. Gjyqtari pasi që bën kontrollin paraprak të kërkesës duhet të organizon caktimin dhe mbajtjen e seancës dëgjimore. Pasi që këto kërkesa janë me natyre urgjente seanca organizohet dhe mbahet kryesisht të njëjtën ditë. Gjithmonë me gjyqtarin kujdestar është edhe zyrtari ligjor i tij.

Pasi që mbahen seancat lëshohet vendimi, ku palët i pranojnë vendimet vet personalisht nga zyra e gjyqtarit të njëjtën ditë (sepse policia pa vendim të gjykatës nuk e largon të pandehurin nga gjykata). Ditën e parë të javës në mëngjes lënda dërgohet në shkrimore ku regjistrohet (paraburgimet regjistrohen në mënyrë manuale jo automatike), vendoset vendimi në SMIL nga ana e gjyqtarit ( nëse lënda paraprake nuk ka qene e regjistruar në SMIL) dhe nëse ka ankese procedohet për në Gjykatë të Apelit.

Këshilli në seancën për këshillim dhe votim, konstatoj se gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica si gjyqtare kujdestare me mos veprimin e saj brenda afatit ligjor për procedim të lëndës së procedurës paraprake PPRKR.nr.741/21, e që si pasojë e këtij mos veprimi në kohë nga ana e gjyqtares ka rezultuar që i pandehuri të lirohet në procedurë të rregullt, me ç'rast e njëjta ka kryer shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve dhe piken 5 të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, ashtu siç ka pretenduar edhe Autoriteti Kompetent.

Veprimet e gjyqtares Krasniqi Jashanica, i kanë cenuar parimet bazë të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe përgjegjësisë që ka gjyqësori, për të promovuar vlerat e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit dhe para gjykatës, e që ndikon në uljen e besimit të publikut në drejtësi të paanshëm.

Sipas raportit të panelit hetimor dhe provave në shkresat e lëndës, gjyqtarja Naime Krasniqi Jashanica me mos trajtimin e rastit penal përkatës, ka shkelur nenin 5, nën pika 1.3 përkatësisht ka kryer shkeljen e detyrës zyrtare si gjyqtar, si dhe ka kryer shkeljen disiplinore të përcaktuar me nën paragrafin 2, pika 2.7 të nenit të lartë cekur. Gjithashtu, gjyqtarja ka shkelur Kodin e Etikës Profesionale për gjyqtar, respektivisht pikën 5, që ka të bëjë me profesionalizmin dhe përgjegjësinë në punë.

KGJK, vlerëson se mosveprimet e gjyqtares për të proceduar dhe organizuar punën rreth kërkesës për sigurimin e të pandehurit në procedurë, janë mosveprime me vetëdije, me ç'rast nënkupton se gjyqtarja ka dështuar ti përmbush përgjegjësit Kushtetuese dhe ligjore. Pretendimi se me mosveprimin e gjyqtares nuk janë shkaktuar pasoja, sipas vlerësimit të Këshillit nuk ka ndikim në vendosjen e masës disiplinore pasi qe nuk mund të merret si rrethanë lehtësuese, sepse gjyqtarja ushtron funksionin në Departamentin e Krimeve të Rënda, ku kërkohet ushtrimi i përgjegjësisë me nivel të lartë të kujdesit, angazhim, profesionalizëm si dhe me integritet për të përmbush kërkesat ligjore në funksion të një gjykate profesionale, objektive dhe të besueshme.

Përveç kësaj, sipas vlerësimit të KGJK-së sjellja e gjyqtares gjatë procedurës disiplinore para Këshillit ka qenë jo serioze, paragjykuese dhe tendencioze.

Deklaratat e subjektit të hetimit të dhënë të Autoritetit Kompetent, të paneli hetimor dhe në seancën dëgjimore të Këshillit nuk kanë qenë koherente, me ç'rastë subjekti i hetimit ka cenuar standardet e etikës dhe për sjelljet në procedure disiplinore dhe rrjedhimisht ka tentuar te pa mundësoj qartësimin e plotë të gjendjes faktike lidhur me mosveprimin e saj në procedurën paraprake.

Këshilli ka vlerësuar që mënyra e veprimit të gjyqtarës Krasniqi Jashanica krijon pasiguri juridike nëse e njëjta do të vazhdoj të ushtroj funksionin në kuadër të Departamentit për Krime të Renda, si Departament që trajton çështje serioze nga fusha të ndryshme të Kriminalitetit. Neglizhenca e gjyqtarës përveç që ndikon në imazhin e gjykatës ndikon drejtpërdrejt në trajtimin jo të barabartë të rasteve dhe palëve dhe rrjedhimisht shkakton qasje selektive për rastet analoge.

Nga gjendja faktike e konstatuar sipas mjeteve provuese të administruara KGJK ka vlerësuar se me provat e administruara e të prezantuara përmes raportit të paneli të hetimit është konstatuar në mënyrë të plotë dhe besueshme se subjekti i hetimit e ka neglizhuar përgjegjësinë për të trajtuar sipas ligjit dhe brenda afateve ligjore, prandaj Këshilli me shumicë të votave ka vendosur që gjyqtarës Naime Krasniqi Jashanica t'i shqiptoj sanksionin disiplinor **transferim të përhershëm nga departamenti i Krimeve të Renda në Departamentin e Përgjithshëm të të njëjtës gjykatë**.

Masa disiplinore e shqiptuar sipas vlerësimit të Këshillit është masë proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit duke siguruar kështu zbatimin e përgjegjësisë ligjore që ka Këshilli në procedurën e disiplinimit të gjyqtarëve sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Masa disiplinore sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duhet të jetë masa e cila ndikon tek gjyqtarja subjekt i hetimit që të korrektoj veprimet e saj, gjatë ushtrimit të funksionit të saj.

Nga sa u tha me lartë, konform nenit 7, paragrafi 1, pika 1.4, dhe paragrafi 2, pika 2.2, 2.4 dhe 2.5 të Ligjit nr.06/1-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilli Gjyqësor i Kosovës**  
**KGJK.nr.318/2022, datë:28 korrik 2022**

Albert ZOGAJ  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit.

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Albina Shabani Rama, Kryetare, Gjykata Themelore në Prishtinë;
- Naime Krasniqi Jashanica, Gjyqtare, në Gjykatën Themelore në Prishtinë;